



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400401/6

Tiranë ___/___/2014

Lenda: *Rekomandojmë marrjen e iniciativës ligjore për njohjen e viteve të punës së bërë gjatë vuajtjes së dënimit me burg për të dënuarit jopolitike, ordinerë.*

Drejtuar: **Z. Erjon VELIAJ**
Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

TIRANË

I nderuar zoti Ministër!

Nga ankesat e depozitura në vite pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, rezulton i pazgjidhur problemi i njohjes së viteve të punës gjatë vuajtjes së dënimit me burg të të dënuarve jopolitikë, ordinerë.

Në këtë kuadër, po ju prezantojmë rastin konkret të një ankese të ardhur së fundmi pranë institucionit tonë.

Sipas shpjegimeve të parashtruara nga ankuesi, shtetasi D.P, banues në Rrëshen, ka qenë i dënuar ordiner për periudhën 09.10.1982-07.08.1990 dhe gjatë vuajtjes së dënimit me burgim ka punuar. Duke qenë se është në prag të pensionit ka bërë kërkesë që t'i njihen vitet e punës së bërë gjatë vuajtjes së dënimit të tij, por nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore nuk i njihen këto vite.

Pas depozitimit të ankesës, iu drejtuam institucionit që Ju drejtoni dhe me shkresën nr.2074/1 datë 18.04.2014, kemi marrë përgjigje se sipas Ligjit Nr.7514 datë 30.09.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", i ndryshuar, neni 5, pika a) për efekt të pensionit të pleqërisë, koha e vuajtjes së dënimit me heqje lirie njihet sa dyfishi i saj. Ndërsa vitet e punuara në burg për ish të burgosurit ordinerë, nuk njihen si vjetërsi në punë për efekt pensioni pleqërie.

Konventa Europiane e të drejtave të Njeriut, në nenin 14, ka përcaktuar se:

“Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë, duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Në nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, thuhet shprehimisht se:

“1. Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj”.

Por legjislacioni shqiptar i sigurimeve shoqërore nuk ua njeh punën e bërë në kohën e vuajtjes së dënimit si vjetërsi pune për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë të dënuarve ordinerë. Nuk ka asnjë akt specifik normativ që të rregullojë situatën e kësaj kategorie. Duke qenë se këta shtetas kanë qenë të privuar nga liria, nuk kanë patur mundësinë që të plotësojnë vitet e punës.

Kjo kategori të dënuarish, kur arrijnë moshën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, marrin ose një pension minimal ose nuk përfitojnë asnjë lloj pensioni pasi nuk plotësojnë kushtin ligjor të vjetërsisë në punë për pension të pjeshëm pleqërie, 15 vjet.

Këta të dënuar kanë kryer punë të papaguar në vitet e vuajtjes së dënimit me burg dhe pavarësisht se me punën e tyre kanë kontribuar në dobi të shoqërisë, kjo punë nuk i konsiderohet si kontribut për të përfituar të drejtën e pensionit të pleqërisë.

Mospërfitimi i kësaj të drejte, ka sjellë pasoja shumë të rënda në jetën e tyre të përditshme. Shumë prej tyre janë të sëmurë, pa familje, pa të ardhura ekonomike dhe e ndjejnë veten të diskriminuar nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 15 të saj ka përcaktuar se:

“ 1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre” .

Duke mos patur mundësinë e përfitimit të pensionit të pleqërisë, të dënuarve ordinerë u janë cënuar liritë dhe të drejtat e tyre themelore.

Për sa më sipër, me qëllim që edhe kategoria e të dënuarve ordinerë të gëzojë të drejtën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, dhe në vijim të nenit 21/b ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e iniciativës ligjore për njohjen e viteve të punës së bërë gjatë vuajtjes së dënimit me burg për të dënuarit jopolitike, ordinerë.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

"Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",

lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Tuaj,

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konc.M.Morina
dt.02.06.2014